



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Procesverbal i mbajtur më 29 janar 2024, në mbledhjen e XX-të (njëzetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:05.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Sylja; Mrika Thaçi dhe Qëndrim Softolli) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe; Saranda Stublla drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ; Pajtim Balaj drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, besoj se me rendin e ditës jeni të njoftuar sepse materiali ju është përcjellë me kohë. Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën lidhur me rendin e ditës, nëse jo unë e kam një propozim për rend të ditës e që për shkaqe teknike ka mbet pa hyrë në rend të ditës, fjala është për Draft Planin lokal të veprimit për barazi dhe mos diskriminim në Komunën e Podujevës për vitin 2023-2026, i cili është diskutuar para disa muajve në Kuvend ku kemi pasë të bëjmë me vënie në konsultim publik.

Pra rastësisht ka mbetur kjo pikë pa e futur në rend të ditës dhe e pranoj gabimin tim për këtë, në qoftë se jeni që të hyj në rend të ditës atëherë vendosim, nëse jo atëherë vendosim që të hyj në një mbledhje tjetër.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, nuk arrita të kuptoj, ajo pikë ka kaluar njëherë.

Mendoj që një pikë si kjo të futet me urgjencë në rend të ditës, fillimisht do të ishte mirë të jetë dikush këtu që ta propozoj atë, e jo ne si Kuvend ta propozojmë, pra nuk e shoh të arsyeshme.

z.Haki Rudari, theksoi, mendojë që pasi nuk ka ardhur me kohë si pikë e rendit të ditës duhet të dihet se kush është sponsorizues i kësaj pike të rendit të ditës fillimisht, dhe mendoj që më mirë është që të trajtohet në seancën e radhës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, atëherë kjo pikë mbetet për mbledhjen e radhës të Kuvendit.

Tani e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialeve dërguara.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e KPF-së, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

1. Propozim Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, siç e dimë Planin e punës e kemi bërë së bashku me komisionin përkatës që është caktuar nga Kuvendi i Komunës në përbërje prej të gjitha subjekteve politike që kanë marr pjesë. Mund të them se interesimi nuk ka qenë i madh nga anëtarët e komisionit, mirëpo e kemi bërë një plan orientues të punës që do të thotë se gjatë vitit edhe mund të ndryshojmë varësisht nga kërkesat e Ekzekutivit dhe interesit të qytetarëve.

Kështu që përbërja ka qenë nga të gjitha partitë politike dhe është një plan që ka dal nga propozimet e tyre, pra nuk është plani vetëm i imi si Kryesues i Kuvendit, andaj kërkoj që t'i propozohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

z.Naim Çunaku, theksoi, kur ne e kemi trajtuar si temë planin e punës së Kuvendit si diçka që është obligim ligjor që të trajtojmë, gjegjësisht që ta kemi planin e punës, edhe atëherë por edhe sot e kemi të ndarë të njëjtin mendim. Nuk mendoj që jemi në nivel të detyrës nëse mundohemi që anën formale të përmbushmi ashtu siç e thotë ligji, e di që këtë herë kemi avancuar sepse e kemi pasur një debat publik të paktën, dhe nuk e di sa ka qenë i suksesshëm e që fundja mendoj që Kuvendi duhet të jetë një shembull për ndjekjen e procedurave, gjegjësisht ofrimin e qytetarit në vendimmarrje, kjo sepse jemi përfaqësues të qytetarëve, demokracia përfaqësuese dhe demokracia e drejtpërdrejtë i kanë dallimet e veta dhe sigurisht që është paraparë që duhet të ndodh për t'iu ofruar të paktën asaj që ish deshtë.

Pra e kemi të njëjtin mendim sërish, nuk e konsideroj një plan të punës pa caktimin e datave se kur do të mbahen mbledhjet dhe nuk e konsideroj një plan të punës pa raport nga diskutimi publik që është mbajtur nga komisioni përkatës. I kam dilemat në përfaqësimin e subjekteve politike se a kanë marr pjesë ata përfaqësues të partive politike apo jo, dhe për fund, një plan pune që në komision është edhe Ekzekutivi i Komunës, flet shumë, flet për shkeljen më të madhe që mund t'i bëhet një plani të punës dhe si të tillë nuk mund të votojmë.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV parimisht e përkrahim planin e punës të Kuvendit, mirëpo ky plan kërkojmë të respektohet. I kemi pak a shumë informatat që i kanë Drejtoritë komunale në plane mujore dhe është mirë që ato që janë të parapara në plan të respektohen. Secili drejtor e ka kohën e vet se kur ka për të raportuar dhe mbi të gjitha mendoj që është mirë që të specifikohen edhe shumë gjëra të tjera e të cilat parashihen edhe me Rregullore se si duhet të bëhet një plani i punës.

Pastaj krahas planit të punës sigurisht që nesër në Kuvend do të del edhe një propozim dhe është mirë të kemi raportin e punës së Kuvendit për vitin e kaluar e që disa Komuna që pak a shumë i përcjellë unë e kanë përfunduar këtë raport. Mendoj që parimisht është mirë që e kemi një plan dhe sigurisht që mund të pasurohet edhe më shumë. U tha që ka qenë diskutimi me qytetarë, por ka propozime që mund të dalin edhe prej këshilltarëve të Kuvendit dhe ato propozime përzgjidhen me ligj dhe rregullore andaj është mirë të inkorporohen në këtë plan të punës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim që ky propozim të kaloj në Kuvend për shqyrtim.

Nga 9 anëtarët e KPF-së, me 6 vota Për, (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Objekti afarist në Zonën Kadastrale Orllan.

- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, si pikë e rendit të ditës sot e kemi propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës-Objekt afarist në Zonën Kadastrale Orllan, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi, andaj kërkoj nga ana juaj që të përkrahet kjo pikë e rendit të ditës.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë propozim vendim.

z.Naim Çunaku, theksoi, dhënia e pronave në shfrytëzim me të dhënat e prezantuara do të krijonte mundësi për marrje në shfrytëzim të atyre pronave. Një e vërtetë e madhe është që ne edhe në vitin paraprak me vendime të Kuvendit kemi pasur një numër të pronave për dhënie në shfrytëzim dhe nuk do të doja të përsëritet viti paraprak, pra ne ato prona i kemi dhe kemi marr një vendim për dhënie në shfrytëzim por që sigurisht drejtoresha e DPKGJ e din sa prej tyre janë dhënë dhe sa kemi qenë ne në nivel të detyrës e që si detyrë parësore e Kuvendit dhe e Kryetarit është ruajtja e vlerës komunale dhe që në të njëjtën kohë atë aset të mos e lë si pronë të fjetur por të jep në shfrytëzim tek qytetarët që të krijohen mundësi punësimi dhe mirëqenie tjetër.

Bëjë apel anëtarëve të Kuvendit që në rend të parë të marrim vendim, por në rend të dytë vendimet e Kuvendit disa po i kuptojnë që nuk e obligojnë Ekzekutivin, por duhet ta dinë që një gjë të tillë e obligojnë dhe për këtë i'a bëjë me dije drejtoreshës së DPKGJ në këtë rast se kur e ceku një mos gatishmëri nga ana e Ekzekutivit përkon me vendimet e Kuvendit, dhe në rend të parë po e potencoj një problem që kisha dashur ndoshta edhe Kryesuesi edhe ju anëtarët e KPF-së po edhe Kuvendi, e kemi parë që për parking këshilltarët e Kuvendit të Komunës kemi vendim që këshilltarët e Kuvendit ta shfrytëzojnë parkingun që është në hapësirat e objektit të Komunës, kështu ka qenë kur ka takime pune Kuvendi, pra është vendim i Kuvendit, ndërsa një drejtoreshë e cila është sjellë nga një Ekzekutiv për të ekzekutuar vendime fillon dhe pleqnon sa këshilltar janë, a ka vend apo nuk ka vend. Sot e ngrita këtu por nesër do ta ngris edhe në mbledhjen e Kuvendit se duhet të mësohemi, nga Kryetari dhe drejtorët, që vendimet e Kuvendit nuk janë për t'u pleqnuar nga Ekzekutivi, por janë për t'i zbatuar.

Po kthehm në temë, ne e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës dhe në njëjtën kohë apelojmë që të bëhet gjithçka që është në dorën tonë dhe e mundshme që ato prona komunale që të mund të shfrytëzohen, gjegjësisht mund të jenë në funksion të një mirëqenie tjetër dhe të një zhvillimi ekonomik, t'iu shkojmë deri në fund dhe t'i bëjmë atraktive për ata operatorë ekonomik që t'i marrin në shfrytëzim e përkrahim, por jo të kemi vetëm vendim të Kuvendit në letër, vërtetë ne si Kuvend e japim vizën por Ekzekutivi t'i përkushtohet kësaj pune dhe pronat komunale të marrin funksionin për të cilin kemi menduar kur kemi marrë vendim të tillë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenie sociale.

z.Bashkim Sylja, theksoi, me qëllim që të mos e marrë fjalën për secilën pikë të kësaj natyre, ne Grupi i PDK-së i përkrahim propozim vendimet për dhënien e pronave në shfrytëzim që janë në këtë mbledhje.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të interesuar për të marrë fjalën, atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

- 3. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00494-0, Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm.**
- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sa kujtoj kjo pronë sipas këtij propozim vendimi ka qenë edhe më herët e paraparë për dhënie në shfrytëzim por nuk është dhënë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

- 4. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00495-4, Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm.**
- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

- 5. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00594-0, Zona Kadastrale Turuçicë.**
- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

- 6. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00596-0, Zona Kadastrale Turuçicë.**
- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

- 7. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00597-0, Zona Kadastrale Turuçicë.**
- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

- 8. Propozim vendimi për caktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike – Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM “Pastrimi” SH.A**

z.Naim Çunaku, theksoi, rreth propozim vendimit për caktimin e kompensimit për anëtarët të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike-Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM “Pastrimi” SH.A, ne në këtë Kuvend kemi vendos të kemi aksionar në KRM “Pastrimi”, pastaj si Kuvend jemi aksionar të Ndërmarrja Banesore, po ashtu në Ndërmarrjen Stacioni i Autobusëve, mandej edhe në Ujësjellës, dhe lind pyetja çka bëhet me ata. Pra t'i japim fund kësaj çështje dhe të shohim kompetencën që t'i caktojmë ndokujt kompensim për një instancë tjetër apo bëjmë shkelje ligjore.

Ne Grupi i LDK-së nuk do të marrim pjesë fare as në votim sepse në atë foltore kur janë ndërtuar komisionet në fjalë ne si Grup i LDK jemi përjashtuar dhe nuk e ka asnjë anëtarë, andaj duke u nisur nga kjo, ai që ka vendosur këtë propozim sigurisht e ka paraparë edhe që LDK nuk ka çka të votoj për diçka që është e përjashtuar.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grup i LVV e përkrahim propozim vendimin për caktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike-Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM “Pastrimi” dhe gjithashtu i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

z.Bashkim Syla, theksoi, fillimisht nuk e di sa kemi të drejtë të caktojmë shumën e kompensimit ne si Kuvend sepse sa e vërejta në material është e cekur shuma e pagës minimale.

Çështja tjetër është që propozim vendimi kur është bërë mendoj se është bërë gabim sepse ka edhe borde/komisione tjera të Ndërmarrjeve e që është dashtë të përfshihen të gjithë ose asnjë, kështu që nuk kam koment për këtë punë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sa i përket bazës ligjore e shqyrtojmë në Kuvend, mirëpo edhe unë mendoj se është mirë të paguhen të gjitha komisionet përkatëse ose të mos paguhen asnjë. Pastaj sa i përket shumës së kompensimit ne nuk mund t'ia caktojmë askujt sepse është Ndërmarrja ajo që i paguan sipas kriterëve të veta. Pra edhe njëherë e them se që është mirë të paguhen të gjitha komisionet e Ndërmarrjeve e jo disa po, disa jo. Si do që të jetë urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Nga 9 anëtarët e KPF-së, me 4 vota Për, asnjë votë Kundër, dhe 1 votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

Procesverbalin e mbajtën;

Enis Sheholli

Nr.Prot.01-060/04-0007468/24

Podujevë,

29 janar 2024

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Hilmi Hoxha